

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BEST BRANDS” SH.P.K.

Sot në Tiranë, më datën 19.05.2023, me cilësinë e ortakëve themelues të shoqërisë:

MIRALD HEKURI i biri i Bardhyl-it lindur më 05.08.1979 në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H90805202E.

ENEA PROTOPAPA i biri i Ilir-it lindur më 01.05.1977 në Korçë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H70501096H.

me cilësinë e Ortakëve themelues, hartojnë këtë akt themelim të Shoqërisë tregtare “**BEST BRANDS**” SH.P.K.

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të shoqërisë tregtare, nënshkruesit dhe themeluesit e saj marrin përsipër të realizojnë e të respektojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë:

THEMELIMI I SHOQËRISË

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, i ndryshuar themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “**BEST BRANDS**” sh.p.k. (më poshtë në këtë



akt e quajtur "Shoqëria") nga Ortakët themelues të saj.

FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria **"BEST BRANDS" SH.P.K.** më poshtë e referuar si "Shoqëria", është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijuar në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe rregullohet prej këtij ligji, dhe statutit të shoqërisë si dhe prej cdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.

II. EMRI I SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1

EMRI

Emri i shoqërisë është **"BEST BRANDS" SH.P.K.** Në cdo dokument, faturë, reklamë dhe publikime emri i shoqërisë do të pasohet nga:

- (i) fjala "me përgjegjësi të kufizuar" apo "sh.p.k"
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

NENI 2

SELIA

Selia administrative e shoqërisë do të jetë në Rr:"Margarita Tutulani", Ndërtesa 10, Hyrja 4, Apartamenti 13, Tiranë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të



Biznesit.

III OBJEKTI I SHOQËRISË

NENI 4

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:

1. *Import - Eksport, tregëtimin dhe magazinimin e artikujve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë të lejuara nga ligji.*
2. *Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit.*

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë cdo veprimtari që do të konsiderohet nga Asambleja e Ortakëve si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin Shqiptar.

IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 kuota me një vlerë nominale si më poshtë:

Z.MIRALD HEKURI – 1 KUOTË ME VLERË 51.000 LEKË

OSE SHPREHUR NË PËRQINDJE:

Z.MIRALD HEKURI – 51%

Z.ENEAL PROTOPAPA - 1 KUOTË ME VLERË 49.000 LEKË

OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:



Z. ENEA PROTOPAPA

- 49%

NENI6

ORGANIZIMI

Shoqëria do të drejtohet nga një Administrator. Këtë detyrë do ta kryej për një periudhë prej 5(pesë) vitesh, **Z. Mirald Hekuri**, i cili do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.

ORTAKËT

“BEST BRANDS” SH.P.K

MIRALD HEKURI



ENEA PROTOPAPA

